



Pranuar / Dorezuar Prilohet / Prodato Received / Delivered	08 - 11	2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organi / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHK/	6912/	2022	114	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.826/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.826/2022 të datës 26.09.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi [redacted] kundër organit të punësimit Komunës së Vitisë, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 08.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa me numër A.nr.826/2022 e datës 26.09.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Vitisë që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr veprime me qëllim të harmonizimit të pagës konform Akt Emërimit me Nr.03-112/2360 të datës 30.12.2011,

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] sipas shkresave të lëndës i punësuar në Komunën e Vitisë, më datë 26.09.2022 përmes postës elektronike, ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e regjistruar me numër protokolli 5670/2022, kundër heshtjes administrative të Komunës së Vitisë, sipas kërkesës së parashtruar nga ankuesi me datë 10.08.2022 në

Komunën e Vitisë, lidhur me kompensimin e diferencës dhe harmonizimin e koeficientit sipas Akt Emërimit.

Komuna e Vitisë gjegjësisht Udhëheqësi i Personelit me datë 15.02.2012 me nr.02-013/171 ka nxjerrë vendim me të cilin ka bërë harmonizimin e Koeficientit të ankuesit \_\_\_\_\_ Zyrtar i Lartë i Personelit nga koeficienti 7.5 në koeficientin 8, por ky vendim nuk është ekzekutuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.10.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vitisë, ndërsa Këshilli më datë 12.10.2022, me numër protokoll 6102/2022, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Vitisë, me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.protokoll 5670/2022 të datës 26.09.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për nivelizim të koeficientit nga shtatë pikë pesë (7.5) në tetë (8) me numër protokoll 02-070/01-33896 e datës 10.08.2022; Akt Emërim i B.L. me numër protokoll 03-112/2360 i datës 30.12.2011; Vendim me numër protokoll 02-013/171 i datës 15.02.2012; Akt Emërim i F.S. me numër protokoll 02-112-04-517 i datës 23.05.2022; Akt Emërim i Z.B. me numër protokoll 06-112/2554 i datës 30.12.2011; Vendim i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokoll 2750/2021 i datës 31.05.2021; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 30.12.2011; Kërkesë me numër protokoll 02-07/169 i datës 15.02.2012; Shkresë me titull Vetëm për ndryshime e datës 01.08.2013; Njoftim komuna e Vitisë me numër protokoll 368 e datës 11.04.2012; Ankesë drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokoll 377/2018 e datës 25.01.2018; Lista e pagave prej datës 01.06.2022 deri 30.06.2022; E-mail nga B.L. për ankesa.kpmsheq@rks-gov.net i datës 26.09.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 06.10.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 6102/2022 e datës 12.10.2022; Konkurs për lëvizje brenda kategorisë i datës 28.06.2021; Kontratë Pune e B.L. me nr. 03-112/286 e datës 02.09.2004; Kontratë Pune e B.L. me nr. 03-112/286 e datës 31.01.2003; Kontrata e Marrëdhënies së Punës e B.L. me numër protokoll 03-112/248 e datës 11.01.2008; Kontrata e Marrëdhënies së Punës e B.L. me numër protokoll 03-112/4967 e datës 02.10.2006; Vendim i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokoll 2312/2022 i datës 21.04.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, është e bazuar pjesërisht sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Akt Emërimit me numër 03-112/2360 të datës 30.12.2011 është i punësuar në Komunën e Vitisë, në pozitën "Zyrtar i Lartë i Personelit" në Departamentin e Administratës. I njëjti me datë 10.08.2022 i është drejtuar me kërkesë për nivelizim të koeficientit nga shtatë pikë pesë (7.5) në tetë (8) Kryetarit të Komunës së Vitisë, Drejtorit të Drejtorisë së Financave dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, ndërsa të njëjtit kanë heshtur dhe nuk i janë përgjigje lidhur me kërkesën e ankuesit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i pakënaqur kundër heshtjes administrative të Komunës së Vitisë lidhur me kompensimin e diferencës dhe harmonizimin e koeficientit sipas Akt Emërimit me përshkrimin e vendit të punës nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në tetë (8) i njëjti kërkon që sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/114 për Zyrtarët Publik përkatësisht neni 19 si dhe Ligji Nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civil konkretisht neni 3 paragrafi 1 dhe 2 ti njihet e drejta e tij.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 19 ku theksohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, ndërlidhur me ketë neni 3 i Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil ka përcaktuar se: *1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rezulton se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civilë të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës ju garantohet dhe duhet të realizojnë pagë të njëjtë për punë të njëjtë, prandaj Kolegji konstaton se Komune e Vitisë është e obliguar nga pranimi i këtij vendimi të filloj pagesën e ankuesit me koeficientin 8.

Kolegji i Këshillit për vendosje meritore të kësaj çështje juridike ka analizuar edhe nenin 7 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin është përcaktuar se: *1. Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat....* andaj, në kuptim të dispozitave ligjore si më lartë dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës Kolegji gjen së organi i punësimit ka ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për harmonizimin e koeficientit të ankuesit mirëpo ky harmonizim nuk është ekzekutuar nga ministria përgjegjëse respektivisht nga Thesari i Kosovës, kështu që, në rrethanat e rastit në fjalë ankuesi në kuptim të realizimit të së drejtës së pagës është dhe vazhdon të trajtohet në mënyrë me pak të favorshme se sa nëpunësit civilë të cilët ushtrojnë pozitë të njëjtë, rrjedhimisht sipas Kolegjit veprimet e tilla lidhur me mos miratimin e harmonizimit të koeficientit të pagës së ankuesit janë në kundërshtim edhe me parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publikë konkretisht nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë, e mbi këto arsye Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara dhe të ligjshme.*

Andaj, bazuar në rrethanat si më lartë, obligohet Kryetari i Komunës së Vitisë që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të bëjë kompensimin e pagës së ankuesit sipas koeficientit të pagës të përcaktuar me Akt Emërimit me Nr.03-112/2360 të datës 30.12.2011.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.826/2022

Çlirim ZEKA

  
Procesmbajtës



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.